



## Periodiku AMF

### I. Mbrojtja konsumatore, një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë që ka Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me mbrojtjen konsumatore (të siguruarit, investitorët dhe kontribuesit e skemave vullnetare të pensione), në konferencën kombëtare “Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve” organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, AMF u përfaqësua nga Zj. Ermela Guxholli, N/Kryetar.

*Vijon në faqen 2*

### II. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

#### II. 1 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - nëntor 2008

Në periudhën janar - nëntor 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 6,535,295 mijë lekë, përkundrajt 5,409,259 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

*Vijon në faqen 4*

### III. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### III. 1 Zhvillohet seminari për rregullatorët e tregjeve në zhvillim të letrave me vlerë

Komiteti Konsultativ i Organizatave Vetërregulluese të IOSCO (**Self Regulatory Organizations Consultative Committee, SROCC**) është një strukturë e IOSCO që ka kontribuar vazhdimisht në zhvillimin e politikave rregullatore, duke siguruar lidhje midis palëve me informacionet dhe vlerësimet si një trupë e organizatave vetërregulluese.

*Vijon në faqen 6*

### III. 2 Çrregullimet e tregut dhe sektori i risigurimeve (Pjesë e shkëputur nga botimi i IAIS: Raporti mbi tregun global të risigurimeve për vitin 2008)

#### KAPITULLI III

Kolapsi i tregut të kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime mortgage) të SHBA, filloi të shfaqej në mënyrë serioze në verën e vitit 2007, në momentin kur krijuesi më i madh i kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime mortgage) falimentoi dhe krijuesi më i madh i kredive hipotekore shkoi fare pranë falimentit.

*Vijon në faqen 7*

### III. 3 Zhvillohet në Angli, seminari ndërkombëtar vjetor, organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Anglisë (FSA)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Anglisë, (FSA) zhvilloi në datat 1-5 dhjetor 2008, seminarin ndërkombëtar vjetor.

*Vijon në faqen 13*

... Vijon nga numri i kaluar

### IV. Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

#### Kapitulli 1

Nevoja në rritje për ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi risqet dhe çështjet e sigurimeve (Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private)

#### Gama e gjerë e produkteve të njohura dhe atyre të reja

Për të përballuar rritjen e risqeve, shpesh me pasoja të dëmshme, tipe të ndryshme policash sigurimi janë krijuar dhe përshtatur për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave në rritje të shoqërisë vendase për të rritur mundësitë e mbrojtjes, kursimit, sigurisë dhe mundësive gjatë daljes në pension.

*Vijon në faqen 14*

## Në këtë numër:

Mbrojtja konsumatore, një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

4

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

6

Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private

14

## Mbrojtja konsumatore, një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare



Zj. E. Guxholli, N/Kryetare e AMF

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë që ka Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me mbrojtjen konsumatore (të siguruarit, investitorët dhe kontribuesit e skemave vullnetare të pensioneve), në konferencën kombëtare “Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve” organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, AMF u përfaqësua nga Zj. Ermela Guxholli, N/Kryetar.

Në këtë konferencë u trajtuan tema në lidhje me konsumatorin nga disa institucione dhe organizata të ndryshme. Fjalën e plotë të mbajtur nga N/Kryetarja e AMF-së me temë: “Mbrojtja konsumatore, një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” do ta lexoni me poshtë.

### I. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Krijimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në Tetor 2006, shërbeu para së gjithash për konsolidimin dhe unifikimin e të gjitha

funksioneve rregulluese dhe mbikëqyrëse mbi aktivitetin financiar jobankar, të cilat para kësaj date ishin kryer nga 3 autoritetet mbikëqyrëse: Ai i sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensione private. AMF erdhi kështu si një realitet i ri në tregun e sigurimeve, duke sjellë më shumë profesionalizëm, siguri dhe koordinim brenda këtij tregu.

Si në fillimet e saj dhe në vazhdim, e gjithë veprimtaria e AMF-së drejtohet nga një mision qartësisht i përcaktuar - mbrojtja konsumatore, e cila ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet strategjike të Autoritetit.

Vizioni i kësaj strategjie është që konsumatori të jetë një individ i mirinformuar, vetpërcaktues, si dhe të jetë në gjendje të orientohet drejt në treg, proces ky që kushtëzohet gjithashtu edhe nga një mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparente e këtij tregu.

Po kështu, vizioni i kësaj strategjie është mbrojtja e cënimit të të siguruarve ndaj rreziqeve, të cilat ato vetë nuk mund t'i trajtojnë.

Konsumatori nën juridiksionin e AMF është i siguruari, investitori dhe kontribuesi në skemat vullnetare të pensioneve.

**Legjislacioni** - Në stadin aktual, legjislacioni shqiptar në fushën e shërbimeve financiare jobankare, vazhdon ta trajtojë mbrojtjen konsumatore në një masë disi të kufizuar. Aktet ligjore që trajtojnë mbrojtjen konsumatore janë:

- Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen konsumatore”.
- Kodi Civil.

Kuadri ligjor i aktiviteteve të sigurimit dhe risigurimit parashikon një sërë masash për mbrojtjen e konsumatorit, por që akoma kanë vend për përmirësime.

Rregullat e përgjithshme për lidhjen e kontratave të sigurimit Jetë dhe Jo Jetë, kushtet e policës së

sigurimit, zgjidhja e kontratës, përgjegjësitë e palëve, përcaktohen dhe nga Kodi Civil. Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 dhe rregulloret e miratuara nga AMF, përcaktojnë disa elemente mbrojtës për konsumatorin, si për kontratat e sigurimit Jo Jetë dhe për sigurimin e Jetës. Ky ligj përcakton gjithashtu një bërthamë detyrimesh të shoqërive të sigurimit dhe brokerimit, përfshirë detyrimin për të vepruar me profesionalizëm, detyrimin e ndershmërisë, detyrimin për të kompensuar dëmet, detyrimin e konfidencialitetit, si dhe detyrime të tjera informacioni.

Në këtë ligj parashikohet dhe detyrimi i shoqërive të sigurimit për krijimin e një sistemi të brendshëm për trajtimin e ankesave.

## ***II. Prioritetet dhe mjetet e Autoritetit në funksion të mbrojtjes konsumatore:***

- **Të fuqizojë konsumatorin, zgjedhja reale e të cilëve bazohet në një informacion të saktë dhe besim që rrjedh nga mbrojtja efektive.**

Objektivi i këtij përcaktimi është që konsumatori të informohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që ai të jetë në gjendje të përzgjedhë dhe të vlerësojë situatën që i paraqitet.

Në lidhje me këtë, Ligji nr. 9267 datë 29.07.2004 dhe aktet e tjera nënligjore, detyrojnë shoqëritë e sigurimit t'i ofrojnë konsumatorit informacionin e përditësuar në lidhje me produktet e sigurimit, kushtet e kontratës, me zgjidhjen e plotë dhe të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, primet, etj.

AMF, në mënyrë të vazhdueshme informon konsumatorin (nëpërmjet medias vizive dhe të shkruar) për krijimin e njësisë për mbrojtjen e konsumatorit, pranë të cilës çdo person mund të drejtohet për të kërkuar sqarime në lidhje me kontratat e sigurimit.

Gjithashtu, në faqen zyrtare të AMF, çdo person

i siguruar mund të verifikojë nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të dhënave të sigurimit të detyrueshëm MTPL, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit. Po kështu, në faqen zyrtare të AMF, gjendet Sistemi GSRM, (tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë), i cili i ka çelur një dritare publikut për t'u lidhur drejtpërdrejt me zhvillimet e fundit të tregut të letrave me vlerë.

- **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve në çështjet e sigurisë dhe vlerësimit të situatës për një zgjedhje sa më të efektshme.**

Bazuar në ligjin e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe udhëzimeve të Autoritetit, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të publikojnë të dhëna si:

- Raportet periodike financiare, së bashku me një raport të shkurtër të ekspertit kontabël.
- Të dhëna vjetore mbi primet dhe dëmet sipas klasave të licencuara.
- Tregues bazë që rrjedhin nga të dhënat financiare, etj.

Informacioni duhet të jetë i besueshëm, i kuptueshëm dhe i përditësuar.

AMF, konform Ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004 dhe Rregullores përkatëse, kontrollon dhe miraton çdo material publicitar të paraqitur nga ana e shoqërive të sigurimit.

- **Sigurimi i konsumatorit për një mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparencë ndaj publikut.**

AMF gjatë gjithë veprimtarisë së saj është fokusuar dhe në mbikëqyrjen e tregut financiar jo bankar.

Rishikimi i kuadrit ligjor si: Projektligji “Mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, projektligji “Për fondet private të pensioneve” është shoqëruar me hapa cilësor, të cilat reflektojnë në pjesën dërmuese të tyre parametrat dhe kërkesat e Bashkimit Evropian. Mbikëqyrja vijoi të forcohet me elementët e bazuar në risk dhe me një sistem të strukturave të analizës financiare sipas modeleve bashkëkohore.

Përpjekja për transparencë ka synuar në vijimësi informimin mbi të gjitha zhvillimet e tregjeve dhe ka shërbyer në të njëjtën kohë për edukimin dhe rritjen e interesit dhe besimit të konsumatorit për produktet financiare.

➤ **Mbrojtja e konsumatorit në mënyrë efektive për rreziqet që kanë ndodhur dhe që nuk mund t'i zgjidhin në mënyrë individuale.**

Miratimi i disa akteve nënligjore si: Udhëzimi për trajtimin e dëmeve, Udhëzimi mbi administrimin e mirë të praktikave të dëmeve, Rregullore për procedurat e trajtimit të ankesave, ka bërë të mundur unifikimin e metodës së trajtimit të praktikave të dëmeve, duke parashikuar në të njëjtën kohë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Krijimi pranë AMF i njësishë së mbrojtjes konsumatore, është një mjet tjetër efikas në mbrojtje të interesave të të siguruarve.

Kjo njësi trajton ankesat për të gjitha rastet që paraqiten si për vonesat në trajtimin e dëmeve, ashtu dhe për ankesa ndaj refuzimit apo masës së dëmshpërblimit.

Procedurat e AMF fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimit ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim konform legjislacionit në fuqi, kontakte të vazhdueshme me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale të çështjes së ankimuar.

Konform legjislacionit në fuqi, AMF kthen pranë shoqërisë për rishikim çështjen e ankimuar dhe më tej nëse çështja nuk zgjidhet, rruga e fundit për zgjidhjen e konfliktit është procedura që parashikon Kodi i Procedurës Civile.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### I. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar - nëntor 2008

Në periudhën janar – nëntor 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 6,535,295 mijë lekë, përkundrejt 5,409,259 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 20.82% nga viti i kaluar, ku 90.05% e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo Jetës, ndërsa 9.95% tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 31.73% të sigurimeve të Jetës dhe 20.05% të sigurimeve të Jo Jetës.

Në periudhën janar – nëntor 2008, volumi i primeve të sigurimit të detyrueshëm u rrit në masën 2.95%, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo Jetës u rrit në masën 60.47%.


Në periudhën janar – nëntor 2008 u lidhën 631,206 kontrata sigurimi, përkundrejt 496,897 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo Jetës kapi vlerën 577,354 nga 459,395 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli “Sigurimi i shëndetit” ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 82,161 kontrata ose në masën 83.48% më shumë se janar – nëntor 2007.

Vlen të përmendet rritja në masën 43.60% e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 53,852, nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” pati një rritje prej 7,071 kontrata ose 62.69%, duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen


e kontratave të sigurimit të Jetës.  
Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar – nëntor 2008, ishte rreth 1,404,781 mijë lekë, ose 15.85% më shumë se në janar – nëntor të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket

sigurimeve motorike me 1,096,478 mijë lekë, apo 80.29% të totalit. Në portofolin "Kartoni Jeshil" kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 8.65% dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 24.56% krahasuar me 11 mujorin e parë të vitit 2007.

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar – nëntor 2008 (Jeta dhe Jo Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar – nëntor 2008 (Jo Jeta)



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - nëntor

| Lloji i sigurimit       | Vlera (në mijë lekë) |                  |
|-------------------------|----------------------|------------------|
| Periudha janar - nëntor | 2007                 | 2008             |
| A) Sigurim i Jetës      | 352,989              | 464,994          |
| B) Sigurim i Jo Jetës   | 5,056,271            | 6,070,301        |
| nga këto:               |                      |                  |
| a) Sigurimi Detyrueshëm | 3,552,688            | 3,657,501        |
| b) Sigurimi Vullnetar   | 1,503,583            | 2,412,800        |
| <b>TOTAL</b>            | <b>5,409,259</b>     | <b>6,535,295</b> |

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### I. Zhvillohet seminari për rregullatorët e tregjeve në zhvillim të letrave me vlerë

Komiteti Konsultativ i Organizatave Vetërregulluese të IOSCO (**Self Regulatory Organizations Consultative Committee, SROCC**) është një strukturë e IOSCO që ka kontribuar vazhdimisht në zhvillimin e politikave rregullatore, duke siguruar lidhje midis palëve me informacionet dhe vlerësimet si një trupë e organizatave vetërregulluese. I krijuar në vitin 1989, në këtë komitet përfshihen 67 anëtarë nga 31 vende të botës, që përfaqësojnë tregjet e letrave me vlerë dhe ato derivative, si dhe të tjera organizata vetërregulluese në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Në datat 8-10 dhjetor 2009, në Washington, USA, u zhvillua seminari për rregullatorët e tregjeve në zhvillim të letrave me vlerë, organizuar nga Komiteti Konsultativ i Organizatave Vetërregulluese të IOSCO.

Agjencitë anëtare të SROCC, të mbledhura së bashku në Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrjes dhe Rregullimit të Letrave me Vlerë, nëpërmjet strukturave të saj, synojnë:

- o Të bashkëpunojnë për promovimin e standardeve të larta të rregullimit dhe mbikëqyrjes, në mënyrë që të mbajnë një treg që funksionon me efikasitet.*
- o Të shkëmbejnë informacion për eksperiencat e tyre më të mira, në mënyrë që ta promovojnë atë në zhvillimin e tregut vendas.*
- o Të bashkëpunojnë për ndërtimin e standardeve dhe një mbikëqyrje efektive të transaksioneve ndërkombëtare të letrave me vlerë.*

*o Të sigurojnë asistencë të ndërsjelltë për promovimin e paprekshmërisë së tregut, duke aplikuar standarde rigoroze dhe një zbatueshmëri efektive kundër shkeljeve.*

Me zhvillimin e globalizimit, progresit në teknologjinë e informacionit dhe diversitetin e metodave të tregtisë në tregjet e letrave me vlerë, sot këto të fundit përballen me shumë sfida dhe ndryshime. Në shumë tregje të letrave me vlerë në botë kanë ndodhur ndryshime radikale në infrastrukturë dhe veçanërisht në sistemet e këmbimit midis vendeve, gjithashtu dhe aktivitetet globale të biznesit nuk janë më një praktikë e panjohur në ditët e sotme. Nga ana tjetër, shumë incidente të mashtrimit që kanë dëmtuar investitorët janë raportuar në shumë tregje gjatë kohëve të fundit. Me qëllim përballjen me këtë situatë, bashkësia ndërkombëtare dhe grupet e koordinimit ndërkufitar midis vendeve, po ndërtojnë rregulla efektive dhe po japin praktikat më të mira për mbrojtjen e investitorëve dhe sigurimin e integritetit të tregjeve të letrave me vlerë.

Nisur nga këto zhvillime, SROCC ka ndërmarrë iniciativë të shumta, me vlerë ndërkombëtare, në kuadrin e katër grupeve të punës së IOSCO. SROCC, gjithashtu ka krijuar grupin e punës për trajnimin e stafit rregullator (**Regulatory Staff Training WG**), me qëllim lehtësimin e kalimit të eksperiencave nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim, iniciativë e cila u pasqyrua dhe në zhvillimin e këtij seminari.

Seminari tregitor ishte planifikuar për herë të parë si një seminar i nivelit të lartë dhe me qëllim trajnimi të tregjeve të vendeve në zhvillim, me parimet e IOSCO dhe zbatimin e tyre në vendet përkatëse. Gjatë seminarit u trajtuan çështjet e mëposhtme:

- o Standardet për ndërmjetësit e tregut. (Standards for market intermediaries)*
- o Inspektimet e firmës, kompanisë. (Firm inspections)*

- o Modele të organizatave vetërregulluese. (*Models of self-regulatory organizations*)
- o Certifikimi i personelit të shitjes. (*Accreditation of salespersons*)
- o Rregullimi tregut. (*Market regulation*)

Në seminar morën pjesë pesëdhjetë e tetë pjesëmarrës nga njëzetë e pesë vende të botës. Gjatë zhvillimit të seminarit u trajtuan këto tema: *Politikat bazë të rregullimit, shembuj të implementimit të politikave bazë, roli i organizatave vetërregulluese, roli i mbikëqyrjes së tregut, rëndësia e krijimit të një rrjeti për shkëmbimin e informacionit pas trajnimit, G20 kriza financiare botërore dhe rekomandimet e FMN për rishikimin e kuadrit rregullator për çështjet që lidhen me krizën e tregjeve financiare.* Në seminar u bë e qartë, se sinjalet e para të sistemit kuptohen kur ai drejtohet si një i tërë, duke theksuar edhe testimin e herëpashershëm dhe rishikimin e kapitalit rregullator, bazuar në kontabilitet.

Një grup pune mbi vetërregullimin, u krijua në këtë seminar dhe erdhi si nevojë pas rezultateve të marra nga një pyetësor drejtuar të gjitha organizatave vetërregulluese.

Seminari vazhdoi më pas me Mbledhjen e Komitetit Konsultativ për Vetërregullim (Self Regulation Organizations Consultative Committee) të IOSCO, që u zhvillua në datën 11 dhjetor 2008.

Në seminar u theksua rëndësia e përmirësimit të transparencës për produktet e letrave me vlerë dhe nevoja për të fuqizuar mbikëqyrjen e tregut.

## II. Çrregullimet e tregut dhe sektori i risigurimeve (Pjesë e shkëputur nga botimi i IAIS: Raporti mbi tregun global të risigurimeve për vitin 2008)

### KAPITULLI III

Kolapsi i tregut të kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime mortgage) të SHBA, filloi të shfaqej në mënyrë serioze në verën e vitit 2007, në momentin kur krijuesi më i madh i kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime mortgage) falimentoi dhe krijuesi më i madh i kredive hipotekore shkoi fare pranë falimentit. Analiza e situatës aktuale të tregut, e cila vazhdon gjatë këtij kapitulli, fillon që në këtë moment dhe merr në konsideratë ngjarjet, në mënyrë specifike ndërlikimet e tyre për sektorin e risigurimeve, të cilat kanë çuar tek kriza e gjerë financiare globale në 2008. Brenda këtij kuadri, ne po paraqesim rezultatet e një studimi të veçantë, i ndërmarrë në pranverën e vitit 2008, i cili anketoj risiguresit dhe rregullatorët të identifikojnë ndikimet kryesore dhe ngjarjet negative të përjetuara deri më tani si pasojë e krizës së kredidhënies. Lexuesit e këtij raporti duhet të jenë në dijeni që ky ishte një pasqyrim i momentit në kohë dhe që, që atëherë çrregullimet në tregun financiar janë intensifikuar në mënyrë të konsiderueshme. Disa vëzhgues të tregut, duke përfshirë Standard & Poor's, një agjenci vlerësimi, kanë deklaruar që aftësia ripërtëritëse e pasqyrës së bilancit të disa prej risiguresve është testuar në pjesën e dytë të 2008 (*Standard & Poor's (2008), "Risigurimet Globale: Kapitali Shtesë amortizon Goditjet deri më Sot; Por ka dhe një Marzh Tjetër të Kufizuar për Gabime"*, *Vlerësime Direkte, Nëntor 25, p. 2*).

Uragani Ike (shiko Kapitullin I) ndikoi në anën e detyrimeve dhe çrregullimet e vazhdueshme financiare kanë pasur një efekt në anën e aseteve. Si rrjedhim, çrregullimi aktual i tregut shikohet gjithashtu brenda kontekstit të industrisë/sektorit të gjerë të risigurimeve, në të cilin ngjarjet që të çojnë në humbje mund të ndodhin në çdo moment. Duke parë përtej episodit të krizës aktuale financiare, ne konsiderojmë instrumentet shpresëdhënëse dhe mekanizmat e reagimit të shpejtë të cilat mund të përmirësojnë gadishmërinë e industrisë së risigurimeve, kundrejt çdo shtate potenciale stresi e shkaktuar

nga katastrofa të mëdha.

Efektet e gjendjes së tanishme tek industria globale e risigurimeve...

Çrregullimi i vazhdueshëm në treg ka qenë fillimisht një çështje për bankat dhe institucione të ngjashme, veçanërisht ato me një ekspozim të theksuar në tregjet e shtëpive në SHBA dhe në vende të tjera. Industria e sigurimeve dhe e risigurimeve, gjithësesi, nuk ka qenë totalisht e izoluar prej ngjarjeve, megjithë faktin që efektet deri më tani kanë qenë më shumë modestë në qëllim dhe shkallë.

Ka disa mënyra në të cilat “ngërçi i kreditit” (eng: credit crunch) mund të ketë një ndikim tek siguruesit dhe risiguruesit:

- o Zvogëlim i vlerës së asetëve të mbajtura si burime kapitali ose për të mbuluar provigjonet teknike.
- o Rritje të kërkesave për kapitalin ekonomik ose të kërkuar të bazuar në risk, nga ana e rregullatorëve.
- o Dëmtshpërblime të shfaqura nëpërmjet linjave profesionale të detyrimeve.
- o Zvogëlime në kapitalin e disponueshëm, në rastin kur kërkohet rikapitalizimi që pason një dëmtshpërblim të madh; dhe
- o Zvogëlim i kapitalit të disponueshëm për financimin e instrumenteve alternativë të risigurimeve siç janë letrat me vlerë për katastrofat.

... kanë shkaktuar probleme të konsiderueshme por jo gjerësisht të përhapura në anën e asetëve...

Siguruesit dhe risiguruesit kanë nën kontroll shuma të konsiderueshme të fondeve të investimeve. Duke u mbështetur në, ndër të tjera, oreksi i tyre për risk dhe kërkesat e rregullatorit lokal, këto janë investuar në klasa të shumëllojshme asetesh, të cilat, si rregull, ekspozojnë siguruesit dhe risiguruesit tek risku

i tregut.

Në dymbëdhjetë muajt e fundit kanë ndodhur rënie të vlerave të një numri të klasave të asetëve, si pasojë e ushqimit të ngërçit të kredidhënies nga anë të ndryshme të sistemit financiar. Në veçanti, letrat me vlerë të mbështetura në asete (eng: asset-backed securities) janë zhvlerësuar në mënyrë të konsiderueshme, së bashku me obligacione të cilat janë “të mbrojtura” nga sigurues që operojnë në tregun sigurimit financiar, siguria e të cilave është në pikëpyetje. Përgjithësisht, ka pasur një rënie në tregun global në tregjet e kapitaleve gjatë vitit 2008.

Përjashtet në përgjithësi konservative të (Ri - ) siguruesve shpesh manifestohen në nivele të larta të diversifikimit, duke nënkuptuar që ekspozimet ndaj çdo pale tjetër janë zakonisht relativisht modeste. Si shembull, një numër risiguruesish paraqitën nivele të ekspozimit tek Lehman Brothers, duke filluar procedurat mbrojtëse nga falimentimi në lidhje me çdo të ndodhte më vonë. Shumica e tyre ishin relativisht modeste në kontekstin e bilanceve të këtyre risiguruesve.

Kuptohet që nëse çrregullimet vazhdojnë, është e mundshme që humbje të mëtejshme të konsiderueshme do të materializohen dhe kjo do të fillojë të ketë një efekt mbi kërkesat e kapitalit të bazuara në risk për risiguruesit. Për cilëndo arsye, për arsye rregullative, ose për qëllime ekonomike të planifikimit për kapital të korporatës, llogaritjet për kapital të bazuara në risk marrin në konsideratë riskun mbi perceptimet e nivelit të tregut (riskun e investimeve) të realizuara nga sigurues dhe risigurues, edhe pse portofolet nuk janë përkeqësuar akoma në vlerë. Gjithsesi, elementi i riskut të investimeve në modele priret të jetë relativisht i vogël (për shkak të metodës konservative në investime e përmendur më lart) duke nënkuptuar që çdo efekt tek kërkesa totale mund të jetë shumë mirë i papërfillshëm dhe shumë larg i rëndësishëm nga çdo rritje në kërkesat për kapital që derivojnë nga nivele të rritura të riskut të marrjes në sigurim të

shkaktuara nga zbutje të vazhdueshme të ciklit.

... dhe një shkallë e lartë e problemeve të pazgjidhura lidhur me detyrimet

Raporti i Standard & Poor vlerësoi humbjet e të siguruarve të ndodhura si rezultat i problemeve aktuale të tregut financiar në “ndërmjet 3 bilion \$ dhe 9 bilion \$” (*Standard & Poor's, op cit, page 5*). Ky interval është i gjerë, por përfaqëson nivele relativisht modeste të humbjeve krahasuar me koston e katastrofave më të fundit natyrore dhe humane. Për shembull, kompania e modelimit të katastrofave RMS aktualisht vlerëson se humbjet të shkaktuara nga Uragani Ike, janë ndërmjet US\$ 6 bilion dhe US\$ 16 bilion. Nuk është e qartë se ç'pjesë e kësaj humbje do të depërtojë në tregun e risigurimeve. S&P vazhdojnë më tej duke deklaruar që shumë pak risigurues e kanë pasur të nevojshme krijimin e një rezerve dëmi të konsiderueshme dhe citojnë një numër të arsyeve të marrjes në sigurim, të cilat mund të nënkuptojnë që ekspozimet e risiguruesve ndaj riskut janë relativisht të vogla. Këto përfshijnë:

- o Ndërprerje e mbulimit për institucionet financiare me qendër në SHBA nga disa risigurues, duke ndjekur humbjet e lidhura me Enron dhe Worldcom.
- o Zvogëlim i limiteve nga ata risigurues që kanë vazhduar të ofrojnë mbulime,
- o duke ofruar mbulime vetëm mbi baza “A”, duke nënkuptuar që kjo vjen si pasojë vetëm nga mos zotërimi i aftësisë paguese e institucionit të lidhur, dhe;
- o fakti që policat janë në përgjithësi të shkruara në baza “të ndodhjes së dëmeve”, duke reduktuar në mënyrë të konsiderueshme riskun e pasuar nga luhajtjet e portofolit.

Si shuma relativisht modeste e humbjeve totale

të pritshme, ashtu dhe masat e marra për marrjen në sigurim të cilat ndjekin humbjet e mëparshme, duket sikur nënkuptojnë që ngërçi i kreditit dhe problemet e shfaqura nga dhënia e huave në tregun e kredive hipotekore, me cilësi të ulët (eng. sub – prime) nuk do të çojnë në humbje të konsiderueshme teknike për industrinë e risigurimeve.

Efektet tek risiguruesit nga çdo rënieje ekonomike globale gjithësesi janë të vështira për t'u gjykuar.

Rritja e kapitalit për t'i paraprirë sfidave të vazhdueshme të tregut ...

Ky është aspekti më i vështirë për t'u parashikuar me çdo shkallë besimi në këtë fazë. Ndonëse 2008 ka qenë një vit në të cilin ka pasur një sezon relativisht aktiv të stuhive në Atlantik, nivelet e humbjeve nga katastrofat kanë qenë të ulëta në mënyrë të konsiderueshme deri më sot, në krahasim me vitin kulmor për katastrofa 2005 dhe kjo ka nënkuptuar që asnjë risigurues nuk ka pasur domosdoshmërinë për të rikapitalizuar deri më sot. Risigurimet vazhdojnë të përfaqësojnë një investim jo të koreluar (me tregjet e tjera financiare), por shkurtimet në fonde në tregjet e parasë përgjithësisht mund të nënkuptojnë, që risiguruesve do t'u duhet të luftojnë për të shtuar fonde shtesë, nëse kjo do të kërkohet.

Shënimi i Standard & Poors (*Standard & Poor's, op cit, page 4*), që së fundmi risiguruesit kanë rritur përmasat në të cilat ata po mbajnë kapital shtesë, ndoshta për t'i paraprirë vështirësive që mund të dalin më vonë duke e ri rritur atë, nëse kjo gjë kërkohet. Gjithashtu ata komentojnë që kjo mund të keqësojë anën e butë të ciklit të marrjes në sigurim (duke përfshirë çmime më të ulëta për mbrojtjen në risigurim), nëse risiguruesit përpiqen të ç'blokojnë kapitalin shtesë që ata kanë mbajtur.

Konkluzione të studimit special të “Raportit mbi Tregun Global të Risigurimeve” mbi krizën e kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime) dhe efektet që lidhen me të.....

Në Maj 2008, GRMR publikoi së bashku me studimin e tij statistikor, dy pyetësorë shtesë, me qëllim vlerësimin e intensitetit të fillimit të krizës financiare për industrinë e risigurimeve. Studimi mbuloi jo vetëm ekspozimin e aseteve të lidhura me tregun kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime) të (ri - ) siguruesve dhe keqësimi në asete, por gjithashtu reagimet nga mbikëqyrësit dhe rregullatorët respektivë.

..... shfaqin probleme serioze dhe të paprecedentë, por aktualisht më shumë ndikime marzhinale.

Në përgjithësi, zhvillimet në tregjet financiare që në 1 Korrik 2007 ishin një burim i problemeve serioze për shumicën e të anketuarve. Shumë i konsideruan ato si të paprecedenta dhe patën frikën e një ndikimi negativ si në anën e aseteve ashtu dhe të provigjoneve teknike të siguruesve (Në këtë tekst, “sigurues” përfshin si sigurim të drejtpërdrejtë ashtu dhe risigurimet, përveç rasteve kur shënohet ndryshe). Disa mbikëqyrës gjykojnë, megjithatë, që zhvillimet kanë ndikuar kryesisht në sektorin bankar dhe kanë reaguar në përputhje me rrethanat. Edhe për ata mbikëqyrës, gjithësesi, presioni i tregut mbi sigurues që operojnë në sigurimin e një klase të vetme si një linjë e vetme garancie financiare, diktoi mbikëqyrje intensive dhe kujdes gjatë periudhës së kontrollimit. Rezultatet e tjera të rëndësishme të studimit janë:

- o Shqetësimi i mbikëqyrësve i fokusuar në rritjen e paqëndrueshmërisë në tregjet e kapitaleve dhe instrumenteve të borxhit dhe në vlerësimin e aseteve e detyrimeve (provigjonet teknike) në pasqyrat e bilancit të siguruesve. Ata janë të shqetësuar në mënyrë specifike mbi deficitet e disa klasave ose instrumenteve të aseteve dhe potenciali për një zgjerim të dëmeve në sigurimin e përgjegjësive profesionale dhe në klasat e tjera të sigurimeve.
- o Të gjithë mbikëqyrësit kanë marrë masa

për të adresuar shqetësimet e tyre të shkaktuara nga çrregullimet në tregun financiar. Disa kanë shpërndarë pyetësorë të përsëritur mbi zbulimet e siguruesve në asete të mbështetura në letra me vlerë (eng: asset backed securities) dhe të humbjeve në kapital në tregjet financiare. Të tjerë i kërkuar siguruesve më të rëndësishëm për raporte periodike të ndryshimeve në asete dhe detyrime. Ndërkohë që të tjerë, ku efektet e çrregullimeve duken të jenë të dobëta, mbajtën me siguruesit e tyre gjatë serisë normale të mbikëqyrjes, diskutime mbi ekspozimin në tregun e kredive me cilësi të ulët (eng.subprime), mbi rritjen potenciale në dëme dhe për masat e mundshme për përmirësimet.

o Të gjithë mbikëqyrësit identifikuan, me një shkallë të ndryshme saktësie, ekspozimin e siguruesve të tyre direkt në asetet e mbështetura në letrat me vlerë dhe derivativet e kreditit. Ky ekspozim në përgjithësi ishte i vogël. Disa nga mbikëqyrësit kërkuar raportime mbi të gjitha produktet financiare të siguruar nga sigurues që operojnë në sigurimin e një linje të vetme garancie. (eng: monoline financial guarantee). Ata gjithashtu u kërkuar siguruesve të raportojnë të dhëna faktike lidhur me instrumente të strukturuar.

o Në detaje të ndryshme, të gjithë mbikëqyrësit konstatuan një ekspozim indirekt të siguruesve të tyre në produktet e strukturuar nëpërmjet pozicionimit të tyre në instrumente financiarë, bazuar në letra me vlerë të tilla. Disa mbikëqyrës kërkuar raporte të ekspozimit në “Shoqëri me qëllim të veçantë” (eng. SPV) dhe risqe të tjera në pasqyrën e bilancit të lidhura me krizën në tregun e kredive hipotekore me cilësi të ulët (eng. subprime). Të gjithë mbikëqyrësit kërkuar që siguruesit e tyre respektivë, të identifikojnë dhe të përcaktojnë madhësinë e humbjeve potenciale ose aktuale nga mbajtja e pozicioneve në instrumenta të tillë financiarë. Këto humbje ishin relativisht të vogla.

o Gjithashtu, të gjithë mbikëqyrësit identifikuan ndikimin e humbjeve në aftësinë paguese të siguruesve të tyre respektivë. Në të gjitha rastet, aftësia paguese e risiguruesve nuk është ndikuar

nga humbjet; kapitali aksioner mesatarisht ishte mbi mesataren e kapitalit të kërkuar nga rregullatorët. Disa mbikëqyrës këshilluan siguruesit e tyre që të ndërmerrnin masa parandaluese dhe korrigjuese, p.sh monitorim nga afër dhe raportim në kohë i zhvillimeve negative, vlerësime të fokusura në risk. Të tjerë nuk ishin të mendimit që instruksione të tilla ishin të domosdoshme duke konsideruar ekspozimin e limituar të risiguruesve ndaj produkteve të strukturuar. o Në momentin që ata lëshuan instruksione të tilla, mbikëqyrësit monitoruan përputhshmërinë nga risiguruesit. Në raste të tilla, përputhshmëria ka qenë e gjerë. o Nuk ka pasur deri më tani ndryshime thelbësore në praktikat e mbikëqyrjes me shfaqjen e problemeve në tregun e kredive me cilësi të ulët (eng.subprime) dhe të çrregullimeve të përgjithshme të tregut gjatë muajve të fundit. o Në krahasim me sa më sipër, siguruesit që operojnë në sigurimin e vetëm një klase garancie financiare (eng: monoline financial guarantee), duket se paraqesin probleme thelbësore. Vazhdon të ketë presione serioze në bizneset që operojnë sipas modeleve të sigurimit në një linjë të vetme, të shkaktuara nga uljet në vlerësime të kreditit dhe veprime të tjera duke ndjekur humbjet pas vlerësimeve sipas vlerës së tregut.

## Zhvillimet më të fundit

Që në momentin e përfundimit të studimit special GRMR (Korrik 2008), kushtet e tregut janë përkeqësuar, duke shkaktuar shqetësime më serioze për të gjithë sektorin e risigurimeve. Konkretisht, një seri paketash shpëtimi që kapin shuma mbi 150 bilion USD u akorduan nga thesari Amerikan i Shtetit për siguruesin në vështirësi AIG, ngjarja më e dukshme dhe e një profili të lartë e ndodhur në këtë industri deri më sot. Duke bërë këtë përjashtim, pasojat më të rënda të krizës janë ndjerë në industrinë bankare. Pas skedimit për

falimentim të Lehman Brothers në 15 Shtator, Morgan Stanley dhe Goldman Sachs zgjodhën të heqin dorë nga investimet e tyre bankare, duke u kthyer në institucione tradicionale të marrjes së depozitave, ndërkohë që Washington mutual, kompania më e madhe e kursim kreditit në SHBA, u konfiskua nga organet shtetërore dhe iu shit JP Morgan Chase. Banka të tjera të mëdha raportuan humbje të konsiderueshme të tremujorit. Jashtë SHBA, disa nga bankat qendrore evropiane, reagan duke zgjeruar huadhënien e emergjencave dhe paketa rikapitalizimi tek institucionet bankare.

Edhe pse në mes të çrregullimeve, sektori i risigurimeve vazhdoi të jetë në mënyrë të krahasueshme elastik edhe duke marrë në konsideratë ngjarje të tjera stresuese, duke përfshirë katastrofa të mëdha të risiguruar si Uragani Ike (2008) dhe Stuhia Dimërore Kyrrill (2007).

IAIS ndihmon me instrumente të kujdesit.....

Rezistenca e kompanive kryesore të risigurimit është jetike në mënyrë që të shuhet çdo goditje e madhe që vjen nga jashtë. Disa nga këto goditje ndikojnë tek risiguruesit në më shumë se një juridiksion. Ky ka qenë rasti i, për shembull, me Uraganet kryesore (Amerika Veriore), Stuhitë (Evropë) dhe Tajfunet (Azi), ku risigurues nga të gjitha anët e botës paguan dëme në juridiksionin (et) respektive të prekura. Disa mbikëqyrës të lartë të (ri-) siguruesve (*Për shembull Steffen 2007*) së fundmi konsideruan prezantimin e një mekanizmi të paralajmërimit paraprak / reagimit paraprak tek IAIS për të mundësuar koordinimin e përpjekjeve në rast të katastrofave të mëdha të risiguruar (*Një vlerësim i metodave të ndryshme të paralajmërimit paraprak gjendet në Berg / Borensztein / Patillo (2004), dhe në Goldstein / Kaminsky / Reinhart (2000) trajtojnë një aplikim të metodave paralajmëruese paraprake në tregjet në zhvillim*).

IAIS dhe veçanërisht RTG, janë shumë mirë në

gjendje të ndihmojnë me një mekanizëm të paralajmërimit paraprak / reagimit paraprak lidhur me katastrofat e mëdha të risiguruara. Si pasojë e një katastrofe, të dhënat e GRMR do të jenë menjëherë të disponueshme për të vlerësuar kapacitetin e industrisë për të shuar goditjen duke siguruar një vlerësim agregat të ekspozimit total. Për më tepër, Sekretariati i IAIS është në gjendje të afrojë mbikëqyrës nga RTG, menjëherë pas ndodhjes së ngjarjeve të tilla, duke ndihmuar në krijimin e besimit reciprok ndërmjet pjesëmarrësve në treg. Në lidhje me këtë, një sistem i tillë i paralajmërimit paraprak / reagimit paraprak ka potencialin të kontribuojë në stabilitetin financiar.

### Duke vlerësuar riskun sistematik të falimentimit

Sistemi global financiar ka përjetuar një periudhë të paprecedentë të çrregullimeve financiare. Disa nga institucionet financiare kanë falimentuar ndërkohë që të tjera duhet të shpëtohen financiarisht nga ndihma qeveritare, duke përfshirë dhe kompaninë më të madhe amerikane të sigurimeve. Cilësia e kredidhënies, likuiditeti dhe problemet që lidhen me aftësinë paguese janë duke u përhapur gjerësisht përtej tregjeve të zhvilluara dhe grupeve bankare në institucione të tjera financiare si dhe në vendet në zhvillim.

Ndërkohë që risiguruesit kanë qenë në mënyrë të krahasueshme, më pak të ndikuar sesa institucionet e tjera financiare, ata nuk kanë dalë të padëmtuar nga kriza financiare. Perceptimi i riskut të mospagimit ndërmjet risiguruesve të mëdhenj është rritur siç paraqitet në grafik nga një rritje shtatëfish në shtrirjen e tyre të kreditit dhe nga 40% humbje në vlerën e tyre të kapitalit (Grafik III-1). Risiguruesit kanë përfituar nga një kuadër më i shtrënguar rregullativ dhe nga politika më konservative

**Grafik: Shtrirja e kapitalit dhe kreditit**  
Burimi: Bloomberg L.P.;  
Vlerësime të stafit të FMN dhe IAIS



investimesh në krahasim me institucionet e tjera financiare. Kjo ka ndihmuar në zbutjen pjesërisht të ndikimit në pasqyrat e tyre të bilancit të rënies së çmimeve të aseteve dhe në limitimin e ekspozimit të tyre në produktet me strukturë komplekse.

Me qëllim paraqitjen në shkallë sasiore të riskut sistematik nga falimentimi në biznesin e risigurimeve, Grafiku III-2 paraqet probabilitetin e nënkuptuar të falimentimeve të përbashkëta të marra nga një shportë e CDS, që përfshin shtatë nga risiguruesit më të mëdhenj botërorë.

**Grafiku III-2: Shtrirja e kapitalit dhe kreditit**  
Burimi: Bloomberg L.P.; vlerësime të stafit të FMN dhe IAIS



(Shikoni kutinë 2-1 në Kapitullin 1 të RTG 2007, për një përshkrim të metodologjisë. Gjithashtu shikoni studimin e FMN 06/105 nga Avesani, Garcia Pascual, dhe Li. Shporta CDS përfshin pesë kompani Evropiane, një kompani Amerikano-Veriore/Caribbeian, dhe një kompani Aziatike.). Bazuar në të dhënat e mesit të nëntorit 2008, probabiliteti progresiv i identifikimit mosfalimentimeve (risk neutral), i cili para krizës ishte mbi 95%, ka rënë në nën 80% gjatë nëntorit 2008.

Më me rëndësi, probabiliteti i identifikimit i më shumë se një falimentimi u rrit me rreth 7%, një rritje me mbi 10 fish që nga fillimet e krizës në korrik 2007. Rritja në riskun sistematik është rezultat si i rritjes së riskut të profilit individual të çdo risiguresi, si dhe gjithashtu një rritje në korelacionet e tyre të kapitalit, nga rreth 30%, përpara krizës, në mbi 50% gjatë nëntorit 2008.

**Përmbledhje** Deri më sot, industria e përgjithshme e risigurimeve ka treguar një rezistencë të konsiderueshme si dhe qëndrueshmëri në krizën e vazhdueshme financiare. Siç edhe studimi special GRMR theksoi mbi ekspozimin ndaj tregut të kredive me cilësi të ulët (eng.subprime), ndikimet e fazave fillestare të krizës së kreditit u ndjenë më së shumti, veçanërisht brenda sektorit të risiguresve, ndërmjet siguresve të linjave të vetme të garancive financiare. Duke qenë se, kriza po thellohet dhe zgjerohet, risiguresit, si të gjithë institucionet e tjera financiare, vazhduan të jenë të ekspozuar ndaj keqësimit të kushteve të tregut. Siç dhe u diskutua në kapitujt I dhe II, profili investues i risiguresve u kufizua në mënyrë të ndjeshme nga problemet e kreditit, ndërkohë që akoma mbeten disa probleme potenciale thelbësore të detyrimeve. Gjithsesi, ky GRMR gjithashtu paraqet një konstatim, se të dyja anët e pasqyrës së bilancit të risiguresve u ndikuan në gjysmën e dytë të 2008: Uragani Ike (shiko kapitullin I) ka një ndikim në anën e

detyrimeve, dhe shtrirja e çrregullimeve financiare ka një ndikim në anën e asetëve. Si përfundim, ne paraqesim këto probleme të tregut brenda kontekstit të mjedisit të gjerë të risigurimeve, ku ngjarjet që çojnë në humbje mund të shfaqen në çdo moment pa asnjë paralajmërim. Lidhur me këtë, IAIS dhe RTG bazuar në të dhënat e GRMR, janë duke punuar drejt mekanizmave të paralajmërimit paraprak / reagimit paraprak, të cilat ne mendojmë që do të jenë instrumente thelbësorë për juridiksionet e risigurimit dhe për të rritur stabilitetin financiar global.

*Shënime:*

*GRMR (eng: Global Reinsurance Market Report) – Raport mbi Tregun Global të Risigurimeve CDS (eng: credit default swaps)*

*RTG (Reinsurance Transparency Subgroup) – Grupi i Punës për Transparencën në Risigurime*

### III. Zhvillohet në Angli, seminari ndërkombëtar vjetor, organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Anglisë (FSA)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Anglisë, (FSA) zhvilloi në datat 1-5 dhjetor 2008, seminarin ndërkombëtar vjetor.

*Temat kryesore të diskutimeve gjatë këtij seminari ishin: Stabiliteti financiar dhe perspektiva ndërkombëtare, bashkëpunimi dhe komunikimi në kohë krize, mbikëqyrja e kompanive të sigurimit, trajtimi i konsumatoreve, Lloyd dhe tregu i Londrës, zhvillimet e fundit, vlerësimi i kapacitetit financiar, si dhe krimi financiar e zbatueshmëria.*

Temat e paraqitura u trajtuan me shumë profesionalizëm dhe pati mjaft diskutime nga

pjesëmarrësit. Identifikimi i çështjeve kritike bashkëkohore, analiza e problemeve si dhe ndarja e eksperiencës me pjesëmarrësit e bëri seminarin mjaft të vlefshëm dhe efektiv.

Analiza e falimentimit të Northern Rock ishte dhe debati më interesant i seminarit.

Gjatë seminarit u analizua e tashmja dhe e ardhmja e iniciativave për menaxhimin e krizës financiare ndërkombëtare, si në Evropë ashtu dhe në Angli. Pjesëmarrës të vendeve të ndryshme, paraqitën praktikën e vendeve të tyre për shkëmbimin e informacionit, menaxhimin ndërkufitar të krizës, si dhe rrugët që duhen ndjekur për të përmirësuar koordinimin ndërkufitar.

Konkluzioni i nxjerrë në përfundim të seminarit, ishte se FSA duhej të realizonte një përjasje të re në mbikëqyrjen e shoqërive, si fokusimi te kapitali në cilësi dhe sasi, kërkesat ciklike për kapital të bazuar në risk, rëndësia e stres testit dhe analiza e modeleve të biznesit.

Në seminar u theksua se: “Është e rëndësishme të kesh politikën ... por ato nuk funksionojnë pa pasur personat e duhur, aftësitë dhe mënyrat.” Forcimi i mbikëqyrjes pas krizës së Northern Rock dhe hartimi i një programi, ishte dhe detyra parësore tashmë për FSA.

Ky program parashikonte një mbikëqyrje më të mirë, efektive dhe rezultate të matshme, të cilat do të arrihen nëpërmjet:

- o Një stafi të trajnuar më mirë,
- o identifikim më të mirë të riskut,
- o nivel minimal të burimeve për shoqëritë me ndikim të lartë,
- o një kulturë të mësimi vazhduar,
- o si dhe angazhimin e të gjithë stafit të FSA, për ta bërë procesin e mbikëqyrjes sa më cilësor.

Parandalimi i problemeve në të ardhmen,

forcimi i menaxhimit të riskut të likuiditetit dhe mbikëqyrja, mbetet parimi themelor që duhet pasur parasysh në punën e të gjitha autoriteteve mbikëqyrëse.

Me mjaft interes, ishte dhe vizita e organizuar në Bankën e Anglisë, ku u bë një prezantim i përbashkët për stabilitetin financiar, si nga drejtori i bankës ashtu dhe nga drejtori i FSA.

Pjesëmarrësit në këtë seminar ishin punonjës të autoriteteve mbikëqyrëse financiare, bankave, kompanive të sigurimit, të rreth 50 vendeve të ndryshme të botës.

Në fund të seminarit u shpërndanë certifikata për të gjithë të pranishmit.

... Vijon nga numri i kaluar

## **Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private**

### **Kapitulli 1**

**Nevoja në rritje për ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi risqet dhe çështjet e sigurimeve (Pjesë e shkëputur nga botimi i OECD: Përmirësimi i edukimit financiar dhe ndërgjegjësimi mbi sigurimet dhe pensionet private)**

### **Gama e gjerë e produkteve të njohura dhe atyre të reja**

Për të përballuar rritjen e risqeve, shpesh me pasoja të dëmshme, tipe të ndryshme policash sigurimi janë krijuar dhe përshtatur për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave në rritje të shoqërisë vendase për të rritur mundësitë e mbrojtjes, kursimit, sigurisë dhe mundësive gjatë daljes në pension. Për sa i përket sigurimit personal, për shembull, një individ mund të zgjedhë midis një morie kontratash të tipit

vullnetar dhe të detyrueshëm, duke përfshirë sigurimin e jetës, shëndetin, invaliditetin, sigurimet për paaftësi dhe kujdesje afatgjatë, si dhe sigurimet e pronës dhe aksidenteve. Pronarët e biznesit të vogël duhet gjithashtu të marrin parasysh sigurimin për dëme, për përgjegjësitë profesionale dhe aksidentet industriale.

Zhvillimi dhe sofistikimi i tregut, shpesh do të thotë që konsumatorët duhet të zgjedhin ndërmjet tipeve të ndryshme të policave të sigurimit për të mbuluar një lloj të njëjtë risku. Për shembull, zgjedhjet janë veçanërisht të shumta për sigurimet personale afatgjata. Në sektorin e sigurimit të jetës, p.sh. sigurimet e përkohshme të jetës ofrojnë sigurim për një periudhë të limituar dhe me një prim relativisht të ulët, ndërkohë që një tjetër mundësi për një investim afatgjatë dhe me prim më të lartë, mund të jenë sigurimet e përgjithshme për gjithë jetën, që në përgjithësi përfitojnë nga lehtësimi i taksave dhe kanë një fleksibilitet më të lartë nga pikëpamja e investimit. Në këtë mënyrë, konsumatorët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për mënyrën e funksionimit të këtyre policave dhe/ose duhet që të këshillohen në mënyrë të duhur se cili është lloji i sigurimit që i përshtatet më së miri jetesës së tyre, situatës familjare, moshës, mundësive familjare e kështu me radhë.

Kjo shumëllojshmëri në rritjen e produkteve të sigurimeve dhe të tipeve të policave, natyrisht që kërkon që konsumatori të forcojë aftësitë dhe njohuritë e tij mbi sigurimin, për ta ndihmuar atë që të bëjë zgjedhjet dhe transaksionet e duhura brenda mundësive të buxhetit të tyre. Në mungesë të aftësive të tilla, zgjedhjet e shoqërisë vendase nuk do të jenë domosdoshmërisht të influencuara nga ekspozimi ndaj riskut, nga shkalla potenciale e dëmit apo nga rëndësia e produkteve të propozuara, por nga kriteret, preferencat apo

kërkesa të tjera.

Shfaqja dhe zhvillimet e shpejta të tipeve të reja jo konvencionale të policave, të tilla si produktet e lidhura me fondet investimit ose, deri diku llogari depozite për shëndetin, të cilat përfshijnë një transferim më të madh të riskut te i siguruari, sjellin njëkohësisht mundësi si dhe rritje risku dhe përgjegjësi të reja për shoqërinë vendase.

Në Evropë, produktet e sigurimit të lidhura me fondet e investimit u rritën me normë mesatare vjetore me 24% midis vitit 1996 – 2000 duke përbërë 45% të totalit të primeve të sigurimit. Kjo tendencë u ngadalësua nga kriza e tregut të kapitaleve në 2001, por që atëherë, shitja e këtyre tipeve të produkteve pati përsëri një rritje të shpejtë dhe tani përbën një pjesë të rëndësishme të sektorit të sigurimit të jetës.

Rëndësia e kësaj lloji police brenda sektorit të sigurimit të jetës është e konsiderueshme dhe është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme sidomos në Shtetet e Bashkuara (ku u zhvilluan në fillim), Australi dhe Kanada. Është gjithashtu e rëndësishme të përmendet fakti, që pavarësisht volumit fillimisht të ulët, aktualisht këto produkte janë duke u zhvilluar me hapa tepër të shpejtë në disa tregje sigurimesh në zhvillim (p.sh në Kinë, Indi dhe tregje të tjera në zhvillim të Azisë). Meqë këto tipe produktesh mund të përdoren për qëllime të ndryshme dhe për të mbuluar lloje të ndryshme risqesh afatgjatë, duke përfshirë dhe sigurimin e jetës, sëmundjet kritike, paaftësitë, përkujdesjet shëndetësore apo përkujdesjet afatgjata, ato kanë të gjitha mundësitë që të fitojnë edhe më shumë rëndësi në vitet në vazhdim.

Rritja e konsiderueshme dhe perspektiva e produkteve të sigurimit që lidhen me fondet e investimit, sigurisht që kërkon nga konsumatorët të kenë një njohje më të gjerë të këtyre kontratave, pasi i siguruari mban riskun e investimit dhe përgjegjësinë për shpërndarjen apo

investimin e aktiveve. Për më tepër, të siguruarit duhet të jenë të informuar plotësisht për vlerën e dorëzimit të kontratës (nëse ato vendosin dhe zgjedhin të mbyllin kontratën përpara se ajo të maturohet) dhe për nivelin e komisioneve që lidhen me to.

Në disa vende, rënia e tregut të kapitaleve dhe për rrjedhojë humbjet nga ky lloj sigurimi në 2001/2002, rezultuan një surprizë e pakëndshme për të siguruarit që nuk e kishin kuptuar, që një produkt i tillë mbante riskun e rënies së vlerës së aktiveve kur ata i blenë këto produkte. Në Suedi, p.sh humbja e kapitalit nga ky lloj sigurimi, solli pakënaqësi të konsiderueshme, pasi të siguruarit nuk ishin plotësisht të informuar për risqet prezente në policat e tyre.

Zhvillimi i produkteve si llogari kursimi për shëndetin në Shtetet e Bashkuara, Singapor dhe Afrikën e Jugut, që mbulojnë një pjesë të shpenzimeve për shëndetin e të siguruarve nëpërmjet policave me pjesë të zbritshme të lartë, gjithashtu transferojnë një sasi të konsiderueshme risku dhe përgjegjësisht direkt tek individët. Këto përgjegjësi duhet të mbështeten nga njohja dhe informimi i duhur për pasojat që mund të kenë këto tipe produktesh dhe nëse ato përkojnë me nevojat e shoqërisë vendase.

### **Evoluimi i mbikëqyrjes së produkteve të sigurimit dhe të të drejtave dhe detyrimeve të konsumatorëve**

Duke pasur parasysh kompleksitetin teknik të sektorit të sigurimeve për konsumatorët jo profesionistë dhe jo ekspertë, shumë anëtarë të vendeve të OECD kanë përcaktuar rregulla të detajuara dhe një mbikëqyrje të gjerë në nivel kombëtar dhe/ose federal/rajonar (p.sh në SHBA, Australi, Kanada dhe Bashkimin Evropian).

Synimi kryesor i këtij kuadri ligjor rregullativ, është t'u sigurojë konsumatorëve mbrojtje më të mirë, të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me produktet e sigurimit dhe ofruesit e shërbimit, si dhe të rregullojnë marrëdhëniet e tyre me siguruesit. Shembuj që janë veçanërisht të vlefshme për t'u përmendur, janë informimi mbi detyrimet, detyrime për blerjen e një police sigurimi specifike, të drejtat e konsumatorëve për kompensim dhe detyrimet e siguruesve. Procesi rregullativ dhe mbikëqyrja kanë gjithashtu qëllim që të kujdesen për zhvillimin e disa tipe produktesh sigurimi-shëndeti, pensionet private, mikrosigurimet dhe mund të përfshijë trajtime fiskale speciale ose mbështetëse financiare. Në këtë aspekt, edhe veprimet dhe rregullat e Qeverisë kërkojnë që konsumatorët të kuptojnë dhe të kenë njohuri mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga të tilla kuadre ligjore të gjera dhe jo detyrimsht të harmonizuara.

Niveli i të kuptuarit dhe njohjes së të drejtave dhe detyrimeve nga ana e të siguruarve lidhur me policat e tyre të sigurimit nuk është gjithmonë i mjaftueshëm. Kjo reflektohet në numrin e praktikave të këqija në lidhje me shitjet si dhe çështjet ligjore të raportuara nga ombucmenët apo autoritetet mbikëqyrëse. Për shembull, në pjesën më të madhe të vende të OECD, moskuptimi i detyrimeve nga konsumatorët në lidhje me kontratat e sigurimit dhe sidomos moskuptimi i informacionit që i duhet dhënë siguruesve kur merret një policë sigurimi ose në rast ndryshimesh, janë shpesh burim vështirësish dhe çështjesh gjyqësore.

Rregullat të cilat janë krijuar për mbrojtjen e konsumatorëve nuk janë domosdoshmërisht të njëjta nëpër juridiksione ose shtete brenda të njëjtës federatë (p.sh Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara). Kështu, konsumatorët duhet të dinë se nëse ndryshojnë vendbanimin e tyre ose zgjedhin sigurues të cilët nuk janë të vendosur në juridiksionin e tyre, është e mundshme që ata nuk do të kenë domosdoshmërisht të njëjtën shkallë

mbrojtje, të drejta dhe detyrime në lidhje me siguruesit dhe kontratat e sigurimit. Për më tepër, siguruesit e produkteve të njëjta të sigurimit mund të jenë të rregulluar në mënyra të ndryshme. Në Kanada, p.sh, fondet e veçuara të investimit që ofrohen nga siguruesit dhe fonde kolektive që ofrohen nga firmat e investimeve, megjithëse të ngjashme, kanë kuadre rregullative të ndryshme.

Gama e gjerë e produkteve të reja të sigurimit dhe zhvillimi i kontekstit të tyre rregullativ, janë gjithnjë e më shumë të vështira për t'u kuptuar, ndërsa në të njëjtën kohë, sigurimet luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e individëve kundër një numri gjithnjë e në rritje të risqeve. Konsumatorët kanë nevojë jo vetëm të jenë të informuar dhe të gjykojnë në mënyrë të drejtë ekspozimin e tyre ndaj risqeve të ndryshme, por gjithashtu kanë nevojë që të zhvillojnë njohuri dhe aftësi më të mira, mbi çështjet e sigurimeve dhe mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre. Këto aftësi po bëhen vendimtare për gjykimin dhe krahasimin nga ana e konsumatorit të informacionit kompleks gjithnjë e më në rritje, përsa i përket policave të sigurimit, si dhe për të bërë zgjedhje sa më të saktë gjatë nënshkrimit të policës së sigurimit.

*Vijon në numrin tjetër ...*

***Për këtë numër punuan:***

E. Guxholli, E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori,  
A. Dervishi, F. Hebovija, E. Beqir-Aga,  
R. Eltari, Dh. Hazbiu, E. Kokona, E. Prenga